



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

**FTESË PËR PJESËMARRJE NË AKTIVITETIN BIZNESOR
(MATCHMAKER ALBANIA)**

27 mars 2025
Vendi: Tiranë
Adresa: Pallati Kongreseve

Me qëllim të promovimit të kompanive kosovare në gjetjen e tregjeve të huaja, zgjerimin e gamës së produkteve për eksport dhe tërheqjen e investimeve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), fton bizneset vendore të marrin pjesë në aktivitetin biznesor “Match Maker Albania 2025”, i cili do të mbahet ndërmjet Kosovës, Shqipërisë dhe shteteve të tjera, dhe organizohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA). Fokus i veçantë në këtë aktivitet do t’u kushtohet takimeve B2B ndërmjet bizneseve kosovare dhe atyre shqiptare, si dhe bizneseve nga shtete të tjera pjesëmarrëse. Kjo është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet KIESA-s dhe AIDA-s.

Aktiviteti **MatchMaker Albania** ka për qëllim thellimin e bashkëpunimit dypalësh dhe krijimin e lidhjeve midis ndërmarrjeve kosovare dhe atyre shqiptare, duke hapur mundësi të reja për zgjerimin e bashkëpunimit në fushën e investimeve dhe eksporteve, i cili parashikon pjesëmarrjen në aktivitetet B2B nga sektorët me prioritet, sipas renditjes si më poshtë:

1. Sektori i turizmit
2. Sektori i patundshmërive
3. Sektori i ushqimit dhe pijeve
4. Sektori për përpunim të drurit dhe përpunim të metalit
5. Sektori i bimëve aromatike dhe mjekësore.

Për të qenë pjesë e këtij aktiviteti, bizneset duhet dorëzuar dokumentet si në vijim:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse në harmoni me sektorët
2. Aplikacionin e plotësuar më të dhënat bazike të biznesit
3. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të biznesit

Dokumentet e lartpërmendura duhet të dërgohen në mënyrë elektronike deri më 16.03.2025, në orën 00:00, në e-mail adresën: invest.kiesa@rks-gov.net; për informata shtesë: +383 (38) 200 36 585.

Shpenzimet e transportit do të mbulohen nga KIESA përmes organizimit të udhëtimit të përbashkët, ndërsa akomodimi dhe shpenzimet e tjera do të mbulohen nga vetë pjesëmarrësit.

Match-Maker Albania

March 27th, 2025



KIESA - KOSOVO

Joined on board